



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Financave

Raporti fiskal mujor

Janar-Qershor 2011

Korrik, 2011

TABELA E PËRMBAJTJES

treguesit fiskale kryesorë për periudhën janar-qershor 2011	2
Analiza e të ardhurave për periudhën janar -qershor 2011	2
Vështrim i përgjithshëm	2
Taksimi direkt	7
Analiza e shpenzimeve për periudhën janar-qershor 2010	11
Vështrim i përgjithshëm	11
Shpenzimet korrente.....	12
Shpenzimet e personelit.....	12
Shpenzimet për interesa	13
Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes	13
Shpenzimet për subvensione	14
Shpenzimet për fonde speciale	14
Shpenzimet të pushtetit lokal	15
Pagesa e papunësisë.....	15
Shpenzimet kapitale.....	16

TREGUESIT FISKALË KRYESORË PËR PERIUdhËN JANAR-QERSHOR 2011

Nga të dhënat e Thesarit të Ministrisë së Financave, për gjashtemujorin e parë të vitit 2011 të ardhurat totale në buxhetin e konsoliduar arritën në 155.3 miliardë lekë (shih tabelen 1). Të ardhurat totale buxhetore ishin 6.8 përqind më të ulëta së parashikimi dhe 1.1 përqind më të larta se një vit më parë. Shpenzimet totale arritën në 181.5 miliardë lekë (shih tabelën 1), 2.8 përqind më të ulëta së planifikimi dhe 7.3 përqind më të larta se një vit më parë. Shpenzimet korrente janë rritur mbi baza vjetore me 7.6 përqind, ndërsa shpenzimet kapitale me vetem 0.1 përqind, duke mbetur ne te njejtat nivele me nje vit me pare.

Deficiti fiskal, i llogaritur si diferenca e të ardhurave me shpenzimet gjithsej të buxhetit të konsoliduar, arriti në këtë gjashtemujor në 26.3 miliardë lekë, 6.2 miliardë lekë më shumë se planifikimi, dhe 10.7 miliardë më i lartë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Deficiti është financuar në pjesën më të madhe me burime të brëndshme (kryesisht huamarrje): 229 milionë lekë janë të ardhurat nga privatizimi të destinuara për financimin e deficitit; 22.5 miliardë lekë të ardhurat nga huamarrja e brendshme neto. Financimi i huaj neto i deficitit ka qenë në nivelin 3.6 miliardë lekë, ose 5 miliardë më pak se planifikimi.

Tabela 1. Treguesit kryesorë të buxhetit të konsoliduar për periudhen janar-qershor

Miliardë lekë	Janar-Qershor '10	Janar-Qershor '11	Planifikimi 2011
TE ARDHURAT TOTALE	153.5	155.3	166.6
SHPENZIMET TOTALE	169.1	181.5	186.7
Nga të cilat: SHPENZIMET KORRENTE	138.8	149.3	145.4
Nga të cilat: SHPENZIMET KAPITALE	32.3	32.3	39.3
BALANCA FISKALE	-15.6	-26.3	-20.1
BALANCA PRIMARE	+3.8	-6.7	+1.5

ANALIZA E TË ARDHURAVE PËR PERIUdhËN JANAR - QERSHOR 2011

Vështrim i përgjithshëm

Të ardhurat e buxhetit të konsoliduar për periudhën 6-mujore arritën në 155.2 miliardë lekë, 6.3 përqind me pak se parashikimi dhe 0.1 përqind me shume se nje vit me pare. Të ardhurat nga tatimet dhe doganat u realizuan në masën 91.8 përqind ndaj parashikimit, ose rreth 108.7 miliardë lekë nga 118.4 miliardë lekë të planifikuara, me rritje vjetore 4.6 përqind; të ardhurat nga pushteti vendor arritën në 6.8 miliardë lekë nga 7.9 miliardë lekë të planifikuara në buxhetin e vitit 2011, me rritje vjetore 6.5 përqind; të ardhurat në fondet speciale arritën 27.7 miliardë lekë nga rreth 28.5 miliardë lekë të planifikuara, dhe kundrejt 26.5 miliardë të një viti më parë, me rritje vjetore 4.8 përqind; te ardhurat nga ndihmat rezultojnë për periudhën 1.1 miliardë lekë nga rreth 1.8 miliardë lekë të një viti më parë; të ardhurat jo-tatimore kanë qenë për këtë periudhë 10.9 miliardë lekë nga 14.9 miliardë të një viti më parë, me renie vjetore 26.9 përqind.

Sipas agjencive te mbledhjes, administrata doganore ka mbledhur 56.2 miliarde leke te mbledhura, 7.5 përqind me pak se parashikimi, me rritje te lehte 2.4 përqind kundrejt 6-mujorit te pare te vitit 2010. Sipas zerave te te ardhurave qe mbledhin doganat, bie ne sy performanca e rentes minerare ne eksport, qe eshte rritur me rreth 64.3 përqind, kryesisht si pasoje e rritjes se

eksporteve te burimeve natyrore si dhe ndryshimeve ne normen e taksimit dhe ne strukturen e takses gjate gjysmes se pare te vitit 2010. Te ardhurat nga akciza ne dogane rezultojne me renie te ndjeshme prej 12.6 perqind kundrejt nje viti me pare. Te ardhurat nga TVSH ne import jane 5.1 perqind me te larta se nje vit me pare, por 8.6 perqind me pak se parashikimi ose 3.9 miliarde leke. Ne mosrealizimin e TVSH-se ka ndikuar dhe ulja e te ardhurave te mbledhura nga akciza.

Të ardhurat në Dogana sipas muajve dhe krahasimi me 2010

Dogana total 2011	Muaji (miliardë lekë)	Në % ndaj muajit paraardhës	Në % ndaj 2010
Janar	8.1	-34.3	13.4
Shkurt	8.2	1.3	9.9
Mars	9.5	16.2	-3.4
Prill	9.4	-1.3	-3.6
Maj	9.9	5.3	-4.8
Qershor	11.1	12	8

Administrata tatimore ka mbledhur ne total 52.5 miliarde leke taksa dhe tatime, ose 7.1 perqind me shume te ardhura se 6-mujori i pare i vitit 2010. Megjithate, TVSH rezulton me 13.2 perqind me pak se nje vit me pare. Administrata tatimore ka rezultate te mira ne mbledhjen e tatim fitimit, akcizes dhe taksave nacionale per 6 -mujorin ne krahasim me te njejten periodhe te nje viti me pare.

Të ardhurat në Tatime sipas muajve dhe krahasimi me 2010

Tatime total 2011	Muaji (miliardë lekë)	Në % ndaj muajit paraardhës	Në % ndaj 2010
Janar	9.0	-2.8	7.0
Shkurt	7.8	-13.9	8.4
Mars	10.7	37.6	17.0
Prill	7.7	-28.0	-4.1
Maj	9.2	19	15.8
Qershor	8	-13	-2.6

Tabela ne vijim pasqyron te ardhurat e mbledhura per periodhen 6 mujore per vitet 2007-2011, te shprehura ne miliarde leke.

Emertimi	2007	2008	2009	2010	2011
Tatimi mbi vleren e shtuar	40.7	49.7	52.1	53.8	54
Tatimi mbi fitimin	10.6	9.8	9.1	8.6	11.3
Akcizat	12.2	14.9	14.4	17.6	17.2
Tatimi mbi te ardhurat personale	5.1	10	13.7	12.5	13.4
Taksa nacionale	7.6	7.3	6.6	8.1	9.6
Taksa doganore	5.0	4.3	3.6	3.2	3.3

Të ardhurat sipas taksave, tatimeve dhe burimeve të tjera

Taksimi i konsumit (indirekt)

Nga TVSH jane mbledhur gjithsej per 6-mujorin 54 miliardë leke, ose 0.3 perqind me shume se nje vit me pare. Te ardhurat e mbledhura jane 14.7 perqind me pak se parashikimi ne buxhetin e rishikuar.

TVSH Dogana 2011	Muaji (milione lekë)	Në % ndaj muajit paraardhës	Në % ndaj 2010
Janar	5,851	-30.8	11.0
Shkurt	6,066	+3.7	16.2
Mars	7,265	+19.8	-4.5
Prill	7,105	-2.2	-1.0
Maj	7,387	+4.0	1.9
Qershor	7,988	+8.1	12.3
TVSH Tatime 2011	Muaji (milione lekë)	Në % ndaj muajit paraardhës	Në % ndaj 2010
Janar	2,899	+26.2	-2.1
Shkurt	2,216	-23.6	-4.3
Mars	1,981	-10.6	-4.4
Prill	1,477	-25.4	-37.5
Maj	1,928	+30.5	-11.8
Qershor	1,811	-6.1	-20.9

Nga Administrata Doganore janë mbledhur 41.7 miliardë lekë TVSH mbi importin, duke realizuar planin e periudhës në masën 91.4 përqind. Të ardhurat nga TVSH-ja në doganë përbëjnë rreth 77 përqind të të ardhurave gjithsej nga TVSH-ja. Ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ato rezultojnë të jenë 2 miliardë lekë më shumë ose 5.1 përqind. Të ardhurat nga TVSH në doganë ndikohen direkt nga vlera e importeve (volumet e importuara, çmimet në import dhe kursi i kembimit) Sipas të dhënave të INSTAT për tregtinë e jashtme gjatë 6-mujorit të parë të 2011, importet në vlerë janë rritur me 15.3 përqind kundrejt një viti më parë të ndikuara edhe nga rritja e çmimeve në import për mallrat kryesore ushqimore në tregjet ndërkombetare ndërsa efekti i kursit të kembimit ka qenë pothuajse i pandjeshëm. Kontributin me të lartë për rritjen e importeve për 6-mujorin e kanë patur këta artikuj: minerale, lëndë djegëse; materiale ndërtimi dhe metale; makineri pajisje dhe pjesë kembimi. TVSH-ja e shtyre për makineri-pajisje për periudhën 6 mujore kap vlerën 1.9 miliardë leke ose 4.2 përqind të planit për periudhën 6 mujore.

Në tabelën më poshtë pasqyrohen të dhënat mbi vlerën e importit për 6-mujorin të makineri-pajisje për vitet 2007-2011, për të cilat aplikohet shtyrja e TVSH-së në import për një vit ose më shumë si dhe vlera e TVSH se shtyre (te shprehura në milione leke).

Kapitulli	2007	2008	2009	2010	2011
84 (makineri, pajisje)	14747	16387	19811	15477	21337
85 (makineri, pajisje)	9583	14224	16270	15900	16738
87 (mjete transporti)	12231	12305	13239	12075	10962
Total	36,561	42,916	49,320	43,452	49,037
TVSH e shtyre		637	1600	1061	1877

Nga administrata tatimore për periudhën Janar - Qershor janë mbledhur 12.3 miliardë lekë nga 17.7 miliardë lekë të planifikuara, që do të thotë -30.4 përqind më pak. Të ardhurat nga TVSH-ja në tatime përbëjnë rreth 23 përqind të të ardhurave gjithsej nga TVSH-ja. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2010, të ardhurat nga TVSH-ja në tatime janë ulur 1.8 miliardë lekë, ose me 13.3 përqind.

Rimbursimi i TVSH-se për periudhën 6-mujore ka arritur shifrën 3.2 miliardë leke nga 2.7 miliardë që ishte një vit më parë, me rritje 19.7 përqind. Kjo ka ndikuar dhe në rritjen e të ardhurave të mbledhura por vetëm me 6.5 % të peshës së diferencës së pa mbledhur nga Administrata Tatimore duke e krahasuar me planin 6 mujor.

Në tabelën më poshtë pasqyrohen disa indikatorë që lidhen me të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar, për ekonominë në teresi, që i referohen periudhës 6 mujore 2010/2011

Emertimi (mln leke)	6M 2010	6M 2011	Ndryshimi	Ne %
Shitjet e tatueshme	466,538	513,625	47,087	+10.1
TVSH e mbledhur (bruto)	16,842	15,492	-1,350	-8.0
TVSH (neto)	14,186	12,312	-1,874	-13.2
Rimbursime	2,656	3,180	524	+19.7
Subjekte pagues	7,330	9,970	2,640	+36.0
Subjekte të TVSH-se gjithsej	19,384	21,308	1,924	+9.9
Teprica kreditore	30,821	31,280	459	+1.5

Sipas 5 sektoreve kryesore të ekonomisë situata e shitjeve dhe pagesës së TVSH-se paraqitet në tabelën në vijim.

Sektore	Shitjet e tatueshme (mln leke)		TVSH e paguar (mln leke)		Subjekte pagues (nr.)		Teprica kreditore (mln leke)	
	2010	2011	2010	2011	2010	2011	2010	2011
Tregti	220,933	250,058	1,950	2,093	2,789	3,024	-14,798	-14,956
Sherbime	65,181	65,853	5,039	3,608	1,665	3,932	-4,701	-3,841
Ndërtim	74,596	76,576	3,789	2,586	1,536	1,644	-2,425	-2,240
Prodhim	95,835	111,579	3,254	3,804	1,070	1,093	-8,097	-9,097
Transport	9,992	9,559	168	227	273	277	-801	-1,145

Nga të dhënat e TVSH-së së paguar sipas sektorëve për gjashtëmujorin vihet re se ka rënie të TVSH-së së paguar nga ndërtimi (me -31.7 përqind) dhe shërbimet (me -28.4 përqind) kundrejt një viti më parë, për një total prej 2.6 miliardë lekë më pak për gjashtëmujorin. Ndërkohë, sektori i prodhimit rezultoi me 16.9 përqind më shumë TVSH të paguar, duke rritur kontributin e këtij sektori në totalin e TVSH-së së paguar. Në të njëjtën kohë teprica kreditore totale e TVSH për 6-mujorin e vitit 2011 rezultoi të jetë 31.3 miliardë lekë nga 30.8 miliardë e të njëjtes periudhe të 2010 me rritje 1.5%.

Taksa doganore

Të ardhurat nga taksa doganore për periudhën Janar - Qershor janë rreth 3.3 miliardë lekë, 11.6 përqind me pak se parashikimi; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2010, të ardhurat nga kjo taksë janë rritur me 75 milionë lekë, ose 2.3 përqind. Niveli mesatar i taksës doganore për këtë periudhë është 1.59 përqind nga 1.74 qe ka qene gjate te njejtës periudhe te 2010. Te ardhurat nga taksa doganore jane ndikuar kryesisht nga rritja e vleres se importeve per periudhen ne fjale, qe ka kompensuar uljen e lehte te nivelit te taksës.

Akciza

Të ardhurat gjithsej nga Akciza për periudhën Janar - Qershor arritën në rreth 17.2 miliardë lekë; ose 2.3 miliardë leke me pak se parashikimi; krahasuar me te njejtën periudhe te vitit 2010, te ardhurat nga kjo takse jane 2.5 % me te uleta ose 437 milione leke. Akciza ka pesuar ndryshime te ndjeshme gjate vitit te kaluar: ne qershor te vitit 2010 u ul akciza mbi kafen e papjekur (nga 70 lek në 30 lek për kg), u hoqen nga lista e mallrave me akcizë lëngjet e frutave dhe pijet freskuese, në grupin e nënprodukteve të naftës shtohet artikulli “naftë virgin” me nivel akcize 50 lek për litër; u shtuan në listën e mallrave me akcizë: fishekzjarret, gommat, pilat dhe bateritë primare, ambalazhet; ndryshoi taksimi i llampave inkandeshente nga ad valorem në shumë fikse. Ne fund te vitit 2010 pati rritje te akcizes mbi cigaren, nga 50 leke ne 70 leke per pakete.

Ajo qe bie ne sy eshte renia e te ardhurave nga akciza qe mbledhin Doganat me 12.6 përqind kundrejt nje viti me pare dhe 14 përqind me pak se parashikimi. Doganat mbledhin akcizën e karburantit të importuar dhe të birrës së importuar, si dhe të mallrave të tjerë që nuk taksohen me anë të pullës së akcizës (sic jane mallrat qe i janë shtuar listës). Sipas llojit të mallrave kryesore me akcizë, situata e zhdoganimeve për periudhën ka qënë si vijon: sasia e karburanteve të zhdoganuar për periudhën Janar - Qershor 2011 është 171 mije ton, me renie vjetore 22 përqind; sasia e cigareve të zhdoganuara për periudhën Janar – Qershor 2011 është 1293 ton, me renie vjetore prej 27 përqind, si pasoje e shtimit te importeve ne muajt e fundit te 2010, para hyrjes ne fuqi te rritjes se akcizes; sasia e birrës së zhdoganuar për periudhën Janar – Qershor 2010 është 13.6 milionë litra, me një rënie prej 11 përqind, e ndikuar nga rritja e prodhimit vendas te ketij artikulli; kafeja e zhdoganuar për periudhën 6-mujore ka qënë 28 përqind më shume.

Nga administrata tatimore janë mbledhur nga akciza rreth 7.5 miliardë lekë, me rritje vjetore 14.5 përqind. Tatimet mbledhin akcizën mbi cigaret dhe pijet alkoolike përveç birrës, përmes pullës së akcizës, si dhe akcizën e karburantit të prodhuar në vënd (ARMO). Ne tabelen ne vijim pasqyrohen te dhenat e te ardhurave sipas mallrave vendi/importi per pesemujorin e 2011 dhe krahasimi me 2010.

Të ardhurat nga akciza per 6 mujorin 2007-2011

Të ardhura, milion lekë	6 mujor 2007	6 mujor 2008	6 mujor 2009	6 mujor 2010	6 mujor 2011
Akciza	12,228	14,940	14,396	17,624	17,187

Ne tabelen ne vijim eshte ecuria e tatimit ne muaj dhe krahasimi me 2010

Akciza Dogane 2011	(miliarde leke)	Ne % ndaj Planit	Ne % ndaj 2010
Janar-Qershor	9.6	-40%	-12.6%
Akciza Tatime 2011			
Janar-Qershor	7.6	-9 %	14.5%

Taksimi direkt

Tatimi mbi të ardhurat personale

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale arritën në 13.4 miliardë lekë, me rritje 7.1 perqind ne krahasim me 6-mujorin e një viti më parë.

Sipas burimit të të ardhurave, të ardhurat nga tatimi mbi pagën e të punësuarve të sektorit publik kanë qenë rreth 4.4 miliardë lekë, me një rritje vjetore prej 5.8 përqind; të ardhurat nga tatimi mbi pagën në sektorin jo-publik kanë qenë 9 miliardë lekë me rritje vjetore prej 6 përqind, cka tregon rritje te indikatorit “wage bill”, qe ndikohet nga niveli i punesimit dhe niveli i pagave, dmth ecuri ne rritje te aktivitetit ekonomik ne vend; performancen me te mire e ka patur sektori prodhues me rritje te pageses se tatimit mbi pagat rreth 34 perqind mbi baza vjetore, pasuar nga sektori i transportit dhe ai i sherbimeve (persa i takon sektorit privat); të ardhurat nga interesat për periudhën janë në nivelin 1.4 miliardë lekë, ose 3.8 perqind me shumë krahasuar me një vit më parë.

Të ardhurat nga taksimi individual per disa burime të ardhurash

Të ardhura, miliardë lekë	6 mujor 2010	6 mujor 2011	Ndryshimi %
Paga sektori public	4,127	4,364	5.8
Paga sektori jo publik	3,945	4,424	12.2
Interesa	1,371	1,423	3.8
Dividendë	290	383	32.1
Shitje pasuri e paluajtshme	1,142	1,037	-9.2

Te ardhurat nga TAP per 6 mujorin e 2008-2011

	2008	2009	2010	2011
Tatimi mbi të Ardhurat Personale (mln leke)	10,092	13,826	12,593	13,368
Sektori Shtetëror	3,526	3,894	4,127	4,364
Sektori Privat	6,566	9,932	8,466	9,004

Persa i takon bazes se taksueshme, subjektet e sektorit privat qe kane deklaruar dhe paguar (ne burim) TAP per gjashtemujorin e ketij viti kane pesuar nje rritje te lehte prej 2 perqindesh ne krahasim me vitin e kaluar, duke u rikthyer ne trendin pozitiv, ndryshe nga e njejta periudhe e vitit te kaluar ku pati nje renie prej 7 perqindesh.

Subjektet tatimpagues ne vite per gjashtemujorin

	Subjekte tatimpagues				Ndryshimi vjetor ne %		
	2008	2009	2010	2011	09/08	10/09	11/10
Total	31,702	37,015	34,319	35,125	17	-7	+2
Publike	2,584	2,061	1,992	2,053	-20	-3	+3
Private	29,118	34,954	32,327	33,072	+20	-8	+2

Tatimi mbi të ardhurat nga biznesi

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin për 6-mujorin 2011 arritën në rreth 11.3 miliardë lekë nga 8.6 miliardë të mbledhura një vit më parë, me një rritje të ndjeshme prej 31 përqind. Sipas sektoreve, kemi rritje vjetore prej 116% te pageses se tatim fitimit nga sektori i prodhimit, ndersa me pagese me te ulet se nje vit me pare rezultojne sektoret e ndertimit me -16.5%, transportit me nje ulje prej -9.8%. Sektori i tregtise dhe sherbimeve kane pasur nje rritje perkatesisht 9.4% dhe 5.5%. Ne rezultatin e te ardhurave per tatim fitimin ne sektorin e prodhimit ka ndikuar derdhja e tatim fitimit nga KESH ne muajin maj per bilancin e vitit 2010, ne shifren 1,147 milione leke dhe Albpetrol (me pagese tatim fitimi 110 milione leke). Edhe per sektorin privat, kemi nje rezultat mjaft te mire krahasuar me vitin e kaluar. Arketimet e muajit mars gjate te cilit behen derdhjet e tatim fitimit bazuar ne bilancet per vitin paradhes per vitin 2011 jane rreth 39 perqind me te larta se marsi i vitit 2010.

Tatimi mbi fitimin rezulton me tejkallim kundrejt parashikimit per periudhen me 1.4 miliarde leke ose 14.3 perqind.

Te ardhurat nga tatimi mbi fitimin per periudhen Janar-Qershor 2008-2011

	2008	2009	2010	2011
Tatimi mbi Fitimin (mln leke)	9,844	9,130	8,642	11,316
Sektori Shtetëror	269	206	184	1,822
Sektori Privat	9,576	8,924	8,458	9,493

Per kete periudhe, subjektet tatimpagues te ketij tatimi rezultojne -303 njesi me pak se nje vit me pare. Ne menyre te theksuar jane rritur subjektet tatimpagues te tatim fitimit ne sherbime me 6.2 % .

Subjektet tatimpagues ne vite per gjashtemujorin

	Subjekte tatimpagues				Ndryshimi vjetor ne %		
	2008	2009	2010	2011	09/08	10/09	11/10
Total	9,727	9,930	10,462	10,159	+2.1	+5.4	-2.9
Publike	35	55	59	77	+57	+7.3	+30.5
Private	9,692	9,875	10,403	10,082	+1.9	+5.3	-3.1

Të ardhurat nga taksa vendore mbi biznesin e vogël arritën në 1.8 miliarde lekë, me rritje vjetore prej 26.7 përqind dhe 97 përqind me shume se parashikimi. Subjektet tatimpagues te takses vendore te biznesit te vogel kane pesuar renie per periudhen (me rreth 2100 njesi) kundrejt nje viti me pare. Shifra 1.8 miliard leke nuk perfshin edhe vleren e takses qe nuk eshte mbledhur per

rimbursimin e cmimit te kasave. Kjo vlere rimbursimi arrin ne rreth 417 milione leke, te perballuara nga fondi i kontingjences se parashikuar ne buxhetin e vitit 2011.

Taksimi i pasurise

Per qellime analize, ketu perfshijme tatimin mbi ndertesat, mbi token bujqesore dhe taksen e kalimit te pasurise se paluajtshme. Eshte prej kohesh nje pjese problematike e sistemit tatimor, persa i takon te ardhurave te mbledhura kundrejt te ardhurave potenciale qe mund te mblidhen nga pasuria e paluajtshme. Administrimi dhe grumbullimi i takses mbi pasurine rezulton te jete pergjithesisht efektiv persa i perket bizneseve dhe institucioneve / organizatave dhe ndjek te njejten tendence ne arritjen e nivelit te parashikuar te te ardhurave me taksat dhe tarifate tjera te aplikueshme nga njesite vendore (tarifat e pastrimit, gjelberimit, ndricimit). Nderkohe, eksperienca nuk eshte e njejte per kategorine "Familjare" te taksapaguesve. Ketu tendenca ne grumbullimin e kesaj takse eshte e ulet, dhe njesite e qeverisjes vendore kane mjaft probleme ne administrim dhe ne detyrimin per pagimin e takses. Per nivelin ende te larte te informalitetit, ka mjaft veshtiresi ne vleresimin e bazes se taksueshme, per arsye te mangesive ne deklarimin real te pasurive. Per 6-mujorin taksat mbi pasurine arrijne ne 1.04 miliarde leke, ose 5.9 perqind me te uleta se nje vit me pare. Ne totalin e te ardhurave tatimore ne Shqiperi ky grup taksash ze vetem 0.7 perqind, kundrejt 6 perqind qe eshte mesatarja e vendeve te OSBE.

Taksat nacionale

Të ardhurat nga taksat nacionale ne total për periudhën, janë 9.56 miliardë lekë nga 8.7 miliardë lekë të parashikuara për periudhën Janar - Qershor. Duke e krahasuar me të njëjtën periudhe të një viti më parë, të ardhurat nga ky grup taksash ka pësuar një rritje prej 17.8 përqind. Me te rendesishmet ne kete grup jane: taksa mbi transaksionin e makinave te perdorura, te ardhurat nga te cilat jane ne renie me 18.3 perqind kundrejt periudhes janar-qershor 2010; taksa e qarkullimit rrugor, me 2.03 miliardë leke te mbledhura (ose 8.4 perqind me pak se një vit më parë); taksa e rentes minerare, qe ka nje rritje te ndjeshme te te ardhurave prej 535 perqind mbi baza vjetore dhe nga e cila janë mbledhur 1.6 miliardë lekë për periudhën; taksat mbi lojrat e fatit, me te ardhura te mbledhura 2.5 miliarde leke, pak a shume i njeiti nivel i nje viti me pare.

Të ardhura të tjera nga pushteti vendor

Të ardhurat e mbledhura nga taksat vendore për periudhën Janar - Qershor arritën në 6.76 miliardë lekë nga 7.9 miliardë lekë të planifikuara në buxhetin 2011, ndërsa kundrejt 6-mujorit të parë të vitit 2010 të ardhurat janë rritur me 411 milionë lekë (rreth 6.5 përqind). Taksat e tjera vendore (pa taksën e biznesit të vogël dhe taksat mbi pasurinë për të cilat folëm më lart) kanë mbledhur rreth 3.9 miliardë lekë nga 1.4 miliarde të parashikuara, me rritje 2.6 përqind më shume se vitin e kaluar.

Të ardhurat e fondeve speciale

Të ardhurat në fondet speciale për periudhën Janar - Qershor 2011 arritën në 27.7 miliardë lekë, me një rritje prej 4.8 përqind kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë dhe 2.6 përqind me pak se parashikimi. Ky grup të ardhurash përbën rreth 19.3 përqind të të ardhurave tatimore

gjithsej për këtë periudhë. Nga totali i fondeve speciale, 26.8 miliardë lekë janë kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 935 milione leke të ardhura për kompensimin në vlerë të pronareve.

Nga sigurimet shoqërore janë mbledhur 24.16 miliardë lekë, me rritje vjetore 8.2 përqind; nga sigurimet shëndetësore janë mbledhur 2.6 miliardë lekë, 20 përqind më pak se 6-mujori i një viti më parë. Përsa i takon bazës së taksueshme, nga të dhënat paraprake të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për periudhën 6-mujore rezultojnë se: në total ka një rritje të numrit mesatar të të punësuarve për efekt të derdhjes së kontributeve (sektor shtetëror dhe sektori privat) prej 8 përqind, ose rreth 28.7 mijë njësi, kundrejt mesatares 6-mujore të 2010.


Numri mesatar mujor progresiv i kontribuesve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

	06-mujor 2008	06-mujor 2009	06-mujor 2010	06-mujor 2011
Ndermarrjet Buxhetore	116,292	128,377	131,690	136,722
Ndermarrjet Shtetërore	30,943	26,250	21,331	22,103
Subjektet Private T.V.SH.	139,788	156,477	165,468	179,948
Subjektet Biznesit Vogel	53,073	63,448	62,548	70,992
Total	340,095	374,552	381,035	409,765

ANALIZA E SHPENZIMEVE PËR PERIUDHËN JANAR – MAJ 2011**Vështrim i përgjithshëm**

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, në fund të muajit qershor 2011, arritën në rreth 182.2 miliardë lekë, nga rreth 186.7 miliardë lekë të parashikuara për këtë periudhë, duke u realizuar në rreth 97.6 përqind të parashikimit të periudhës ose me një mosrealizim prej rreth 4.5 miliardë lekë. Krahasuar me planin vjetor, këto shpenzime janë realizuar në rreth 44.5 përqind, ndërsa kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë, shpenzimet buxhetore rezultojnë rreth 11.1 miliardë lekë më shumë ose rreth 6.5 përqind më të larta. Ecuria e shpenzimeve buxhetore në shumë absolute, ritmi i rritjes së tyre gjatë gjashtëmuajorëve të parë, në disa vite, si dhe ritmi linear i rritjes, jepet në grafikun e mëposhtëm:

Shpenzimet e përgjithshme janar-qershor në vite



Shpenzimet e përgjithshme sipas elementëve kryesore përbërës të tyre, realizuar gjatë periudhës janar-qershor 2000-2011, në milionë lekë, jepen në tabelën e mëposhtme:

SHPENZIMET NE VITE 6-MUJORI I PARE

ne milion lekë

	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
TOTALI I SHPENZIMEVE	71,326	82,848	80,825	88,726	94,369	102,880	95,353	105,385	136,889	178,245	171,039	182,166
I. Shpenzime Korrente	59,902	65,825	69,862	77,649	83,624	89,715	87,066	94,158	107,465	129,607	138,778	149,117
1 Personeli	15,087	18,414	18,448	20,298	22,233	24,582	25,281	25,589	29,991	29,611	31,862	32,940
2 Interesat	15,415	12,855	12,100	15,118	15,354	13,155	12,162	12,055	14,999	17,423	19,415	19,552
3 Shpenzime Operative Mirembajtje	7,634	6,834	8,633	10,126	10,216	11,031	8,647	9,790	10,451	13,931	15,406	16,001
4 Subveconet	1,306	4,085	3,963	1,747	2,087	1,729	1,258	1,270	884	1,184	777	2,372
5 Shpenzime per Sig.Sociale	14,333	16,725	18,609	20,720	23,416	26,185	27,938	32,346	35,022	44,939	48,818	53,929
6 Buxheti lokal	2,084	2,760	4,119	5,669	5,990	8,045	7,067	7,909	10,469	15,083	14,122	14,684
7 Shpenzime te tjera	4,043	4,152	3,990	3,971	4,328	4,988	4,713	5,199	5,649	7,436	8,378	9,639
II. Shpenzime Kapitale	11,424	17,023	10,963	11,077	10,745	13,165	8,287	11,227	28,016	48,553	32,261	33,049
1 Financimi Brendshem	5,863	8,576	5,647	6,164	6,503	8,240	5,638	8,717	11,307	40,796	24,583	24,171
2 Financimi Huaj	5,561	8,447	5,316	4,913	4,242	4,925	2,649	2,510	16,709	7,757	7,677	8,678

Në analizën e shpenzimeve për periudhën janar-qershor 2011 duhet mbajtur parasysh fakti se në realizimin faktik të tyre, janë përfshirë edhe shpenzimet nga fondi rezervë i Këshillit të


Ministrave dhe nga fondi i kontigjencës për ruajtjen e deficitit. Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, i planifikuar në 1.5 miliardë lekë për vitin 2011, deri në fund të muajit qershor është ekzekutuar në rreth 1.17 miliardë lekë, përkatësisht rreth 205.0 milionë lekë për shpenzime për paga, rreth 321.9 milionë lekë për shpenzime të tjera korrente dhe rreth 645.7 milionë lekë për investime.

Fondi i kontigjencës për ruajtjen e deficitit, i planifikuar në rreth 3.65 miliardë lekë, deri në fund të muajit qershor është përdorur në rreth 1.14 miliardë lekë në formën e subvencionit, për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale dhe taksimetrave, tek njësitë e qeverisjes vendore.

Shpenzimet Korrente

Shpenzimet korrente në fund të muajit qershor 2011, kanë arritur në rreth 149.1 miliardë lekë ose rreth 102.6 përqind të parashikimit të periudhës, duke rezultuar me një tejkalim prej rreth 3.7 miliardë lekë. Krahasuar me planin vjetor këto shpenzime janë realizuar në rreth 46.4 përqind, ndërkohë që krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, këto shpenzime rezultojnë rreth 10.3 miliardë lekë më të larta ose rreth 7.5 përqind më shumë.


Shpenzimet korrente janar-qershor



Shpenzimet e Personelit

Brenda shpenzimeve korrente, shpenzimet e personelit, që përfaqësojnë rreth 22.1 përqind të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara gjatë periudhës janar-qershor 2011, rezultojnë rreth 9.2 përqind më shumë se parashikimi i periudhës. Kundrejt planit vjetor këto shpenzime në fund të muajit qershor janë realizuar në rreth 47.4 përqind të tij, ndërkohë që krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë shpenzimet e personelit rezultojnë rreth 1.1 miliarde milionë lekë më të larta, ose rreth 3.4 përqind më shumë.

Shpenzimet për personelin janar-qershor




Shpenzimet për paga janë në të njëjtën kohë rreth 3.5 përqind më të larta se një vit më parë ose rreth 958 milionë lekë më shumë se një vit më parë, ndërkohë që shpenzimet për sigurimet shoqërore janë rreth 128 milionë lekë më shumë ose rreth 2.8 përqind më të larta, se një vit më parë.

Shpenzimet për Interesa

Shpenzimet për interesa që përfaqësojnë rreth 13.1 përqind të totalit të shpenzimeve korente të realizuara gjatë periudhës janar-qershor 2011, rezultojnë me një kursim prej rreth 2.0 miliardë lekë, rrjedhojë kjo e kursimit për rreth 1.4 miliardë lekë në interesat e brendshme dhe rreth 558 milionë lekë në interesat e jashtme. Kundrejt planit vjetor interesat janë realizuar në rreth 40.9 përqind, ndërsa krahasuar me një vit më parë ato rezultojnë rreth 137 milionë lekë më të larta ose rreth 0.7 përqind më shume. Ecuria e shpenzimeve për interesa gjatë gjashtëmuajve të parë, në vite jepet nga grafiku i mëposhtëm:

Shpenzimet për interesa janar-qershor




Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes gjatë periudhës janar-qershor 2011 arritën në rreth 16.0 miliardë lekë duke qënë rreth 1.7 miliardë lekë mbi nivelet e parashikuara. Kundrejt planit


vjetor këto shpenzime janë realizuar në rreth 48.6 përqind të tij. Në të njëjtën kohë ato rezultojnë rreth 595 milionë lekë më të larta se një vit më parë ose rreth 3.9 përqind më të larta.

Shpenzimet O&M janar-qershor



Shpenzimet për Subvensione


Shpenzimet për subvencione në fund të muajit qershor 2011 arritën në rreth 2.4 miliardë lekë ose rreth 1.6 miliardë lekë më shumë se parashikimi. Këtu duhet marrë parasysh edhe fakti i përmendur më sipër se rreth 1.14 miliardë lekë janë dhënë me vendime të Këshillit të Ministrave, në formën e subvencionit, për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale dhe taksimetrave, tek njësitë e qeverisjes vendore.



Shpenzimet për Fonde Speciale

Shpenzimet për fonde speciale gjatë periudhës janar-qershor 2011 rezultojnë rreth 1.7 miliardë lekë më pak apo rreth 3.1 përqind nën nivelin e parashikimit të periudhës. Kjo situatë është rrjedhojë e mosrealizimit prej rreth 2.4 miliardë lekë të shpenzimeve për sigurimet shoqërore, e rreth 707 milionë lekë tejkalim në shpenzimet për sigurimet shëndetësore dhe e rreth 18 milionë lekë tejkalim në shpenzimet për kompensimin e ish pronarëve. Kundrejt planit vjetor shpenzimet për fondet speciale janë realizuar në nivelin 46.2 përqind, nga të cilat sigurimet shoqërore janë realizuar në rreth 47.1 përqind të planit vjetor, sigurimet shëndetësore në rreth 46.9 përqind dhe shpenzimet për kompensimin e pronarëve në rreth 45.3 përqind të këtij plani.


Krahasuar me një vit më parë shpenzimet për sigurimet shoqërore rezultojnë rreth 3.0 miliardë lekë më të larta ose rreth 8.2 përqind më shumë, ndërsa shpenzimet për sigurimet shëndetësore rezultojnë rreth 1.2 miliardë lekë më të larta, ose rreth 10.0 përqind më shumë.



Shpenzime të Pushtetit Lokal

Shpenzimet e pushtetit vendor zënë rreth 9.8 përqind të shpenzimeve korrente. Për periudhën janar- qershor 2011 ato kanë arritur në rreth 14.7 miliardë lekë nga rreth 14.1 miliardë lekë të planifikuara për këtë periudhë të vitit 2011, duke rezultuar me një tejkalim prej rreth 593 milionë lekë ose rreth 4.2 përqind më shumë se plani i periudhës. Kundrejt planit vjetor këto shpenzime kanë arritur në rreth 46.2 përqind të tij. Krahasuar me një vit më parë këto shpenzime rezultojnë rreth 562 milionë lekë më të larta ose rreth 4.0 përqind më shumë. Ecuria e shpenzimeve të pushtetit vendor për periudhën janar-qershor për disa vite jepet nga grafiku i mëposhtëm.

Shpenzimet për pushtetin lokal janar-qershor




Pagesa e Papunësisë

Pagesa e papunësisë është realizuar në rreth 87.1 përqind të parashikimit të periudhës, duke qënë rreth 38.6 përqind e parashikimit vjetor dhe në të njëjtën kohë rreth 76 milionë lekë më pak se viti i kaluar ose rreth 15.2 përqind më pak se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Ndihma ekonomike gjatë periudhës janar-qershor 2011 rezultojnë rreth 247 milionë lekë më shumë ose rreth 3.3 përqind mbi parashikimin e periudhës, duke qënë në të njëjtën kohë rreth

45.5 përqind e planit vjetor. Kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë ndihma ekonomike rezulton rreth 0.8 përqind më e ulet ose rreth 63 milionë lekë më pak.

Shpenzimet për mbrojtjen sociale janar-qershor




Shpenzimet Kapitale

Shpenzimet kapitale deri në fund të muajit qershor 2011 janë realizuar në nivelin 84.1 përqind të parashikimit të periudhës ose në rreth 40.1 përqind të planit vjetor. Këtu duhet të mbahet parasysh se rreth 645.7 milionë lekë janë dhënë nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për investime. Brenda këtyre shpenzimeve, investimet me financim të brendshëm janë realizuar në masën 53.8 përqind, ndërkohë që investimet me financim të huaj janë realizuar në masën 23.1 përqind të parashikimit vjetor.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar investimet e brendëshme rezultojnë rreth 412 milionë lekë më të ulta ose rreth 1.7 përqind më pak, ndërkohë që investimet me financim të huaj rezultojnë rreth 1.0 miliardë lekë më të larta ose rreth 13.0 përqind më shumë. Për rrjedhojë, investimet në total në fund të muajit qershor 2011 janë rreth 2.4 përqind më të larta ose rreth 0.8 miliardë lekë më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Shpenzimet kapitale janar-qershor



Struktura e investimeve kapitale të realizuar gjatë periudhës janar-qershor 2011 është rreth 73.1 përqind nga financimi i brendëshëm dhe rreth 26.3 përqind nga financimi i huaj.